



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:033010

Datë: 10.05.2022

Numri i dokumentit: 02990764

PKR.nr.162/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, në përbërje të trupit gjykues nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryetare e trupit gjykues, Shaq Curri dhe Veton Ademaj anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, si procesmbajtëses, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.A nga fshati L K- Pejë, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 2 pika 2.1 dhe 2.5 dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të rënda, PP/I.nr.388/2014 të datës 15.10.2015, pas mbajtje së shqyrtimit gjyqësor në prani të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të dëmtuarit D. A, të akuzuarit A. A, dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Shaban Shala, me datë 05.04.2022 mori dhe shpalli si dhe me datë 10.05.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. A, i biri i N dhe nenës S e gjinisë K, i lindur me dt. ne fshatin L K- Peje, tani me banim ne P, rr. “ B Sh“ nr. ., ka te kryer shkollën fillore me profesion, i martuar baba i, i gjendjes se dobët ekonomike shqiptar shtetas i Republikës Kosovës,

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKTAKUZA

Për shkak se:

I. Me dt. 19.08.2014, rreth orës 20:00 në fsh. K- P., më qellim të përvetësimit në mënyrë të kundër ligjshme merr sendet e luajtshme pronë e te dëmtuarit D A nga i njëjti fshatë në atë mënyre që i pandehuri duke u siguruar se nuk gjendet askush tek shtëpia e të dëmtuarit i cili me familjaret e tij sapo ishte larguar nga shtëpia natën kritike i njëjti është afruar dhe me forcë ka hapur një dritare te dhomës se ndejës (sallonit) së shtëpisë, me ç’rast kur ka depërtuar brenda në shtëpi ka përvetësuar një telefon të markës IPHONE me ngjyrë të bardhë me nr. IMEIT – ne të cilin kishte qenë kartele me numër me vlerë prej 250 euro, një pushkë gjuetie e kalibrit 12 G.. me numër serike prodhimit t., tri unaza ari me vlerë prej 450 euro, dy burme ari me vlerë prej 300 euro, tri byzylyk me vlerë prej 600 euro, dy palë vathë me vlerë prej 300 euro, dy komplete argjendi njëra me mbishkrimin S.“në vlerë prej 400 euro, një komplet ari i kuqë i firmës “ Filigran”

punim dore në vlere prej 3500 euro, një komplete ari në vlerë prej 150 euro, një unazë e femrave me gurë me mbishkrim S.” me diamant me ngjyrë të bardhë, dy komplete argjendi me mbishkrimin “ B. “ si dhe disa unaza dhe vathë tjerë të arit e pastaj i pandehuri ishte larguar nga vendi i ngjarjes ndërsa që pas disa dite telefonin e vjedhur ia kishte shitur dëshmitarit B. S.

- me çka kishte për të kryer veprë penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 2 pika 2.1 dhe 2.5 të KPRK-së,

II. Më parë ka siguruar e gjerë me dt. 19.08.2014, rreth orës 20:00/h, pa autorizim ka mbajtur armë dhe atë një pushkë gjuetie e kalibrit 12 G. me numër serik ... e prodhimit T. e te cilën armë natën kritike kishte vjedhur tek shtëpia e te dëmtuarit D. A na fshati V K-Pejë.

-me çka kishte për të kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari D. As udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të rënda, ka ngritë aktakuzë PP/I.nr.388/2014 të datës 15.10.2015, akuzuarit A. A nga fshati L K- P., për shkak te veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 2 pika 2.1 dhe 2.5 dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se.

Gjykata ka vendosur lidhur me këtë çështje sipas aktgjykimit DKR.nr.250/2015 të dt.22.11.2019, ashtu që për veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.2 pika 2.5 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim me murg në kohëzgjatje prej 3 vite dhe me dënim me gjobë në shumën prej 200€ (dyqind euro) si dhe është obliguar që në afat prej 15 ditësh të paguaj dënimin me gjobë , nëse nuk do ta paguan atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 15 eruo të gjobës është obliguar në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale në shumën prej 200 eruo dhe paushallit gjyqësor në shumën prej 40 euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimin shumën prej 50 euro. Për veprë penale mbajtja në pronësi kontrolle dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, është refuzuar aktakuza për shkak se konsumohet në veprën penale nga pjesa e parë e aktgjykimit. I dëmtuari D. A është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë brenda afatit ligjor kanë paraqitur:

Prokurori i shtetit me dt. 27.01.2020 për shkak të vendimit mbi dënim dhe për shkak të gjendjes faktike për pjesën refuzuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Bekë Lajqi me dt. 29.01.2020 për shkak të shkeljes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm nga

një gjykatë e pavarur me rastin e ndarjes së drejtësisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, aplikimit të gabuar dhe jo të drejtë të dispozitave të së drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin dhe shpenzimeve të procedurës penale dhe kompensimin për viktimat.

Gjykata e Apelit me aktvendim PAKR.nr.95/2020 të dt.16.06.2020 duke vepruar sipas ankesës së prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit dhe sipas detyrës zyrtare e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje

Gjykata ka mbajtur seancën e rishqyrtimit gjyqësor ku i akuzuari është njoftuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës. Pastaj gjykata ka vazhduar me procedurën e provave.

Provat e administruara

Në procedurën e provave është dëgjuar fillimisht fjala hyrëse më pas janë administruar këto prova:

- Është dëgjuar i dëmtuari D.A, dëshmitarët Sh. B dhe B. S. - Provat materiale: raporti i informues me numër te rastit .. -...- ... i dt. 28.10.2014 i përpiluar nga hetuesi policore T. H,
- Procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë se M. B i dt, 28.10.2014-
- Dëftesa mbi konfiskimin e IPHON-4 ngjyrë të bardh me numër te imeit i konfiskuar nga dëshmitari B.S,
- raporti i IPKO-s i dt. 08.09.2014, i nxjerr në bazë të urdhëresës së gjykatës për të dhënat e numrit të abonentit që ka shfrytëzuar IMEI-n.
- fotografit e telefonit te konfiskuar,
- tri faqe te komunikimit nëpërmes te facebook në telefonin samsung,
- raporti i hetuesit S.H me numër te rastit ..- ...-..., i dt. 20.10.2015,
- rezultati i ekzaminimit nga Njësia e Forenzikës Sektori i Afisit i dt. 24.09.2014,
- deklarata e dhëne ne prokurori nga ana e dëmtuarit D. A me dt. 19.11.2014,
- deklarata e dëshmitarit Sh. B te dhëne ne prokurori me dt. 19.11.2014,
- deklarata e dëshmitarit dhëne ne polici e B. S me dt. 30.10.2014,
- deklarata e te akuzuarit A.A e dhëne ne prokurori me dt. 19.11.2014,
- deklarata e dëshmitarit Sh.B e dhëne ne polici me dt. 29.10.2014,
- deklarata e te pandehurit A.A e dhëne ne polici me dt. 31.10.2014.

Deklaratat e dëshmitarëve

I dëmtuari D. A në deklaratën e dhënë para gjykatës në rishqyrtim gjyqësor të dt.06.01.2022 ka deklaruar se: - “mbetem pranë deklaratës që ka dhënë me herët. Ditën kritike ka qenë me hëngër darkë në R, janë kthyer rreth orës 22:00/h, nuk mund te them saktë, na kur jemi hyre ne oborr kemi pare shtëpinë te ndriçuar, edhe unë jam habitur dhe ju kam thanë familjarëve se unë si kam lënë dritat dhezë, e kam futur çelësin në derën e hyrjes kryesore, dhe menjëherë prej korridorin kam hy në sallon dhe gjerat kanë qenë rrëmuje, faktikisht në secilën dhomë ka qenë rrëmujë, të gjitha ato çka janë të përshkruara në aktakuze janë vjedhur, i është vjedhur edhe një telefoni mobil IPHON po iu ka kthyer nga policia. Pushka e gjuetisë po ka qene me leje valide, po leja ka skaduar. Pushka nuk i është kthyer”.

Me tutje ka deklaruar se është e vërtetë se të nesërme apo pas dy - tri ditëve ka shiquar video-incizimin te kojshia përtej rrugës diku ne distancë prej 150 metra prej shtëpisë së tij, pra ka shquar kamerat. Pas shqimit nuk i kujtohet se a ka lajmëruar policinë, por e dinë çka ka parë në kamera. Nuk e di se kur kanë hyje, por në kamera i ka pa kur kanë dal, nga se në pjesën tjetër të oborrit shifet se i kanë prishur telat por atje nuk ka kamera. E ka përshkruar se katër persona kanë ecur në këmbë, ndërsa një person ka zbritur nga automjet ju ka bashkangjitur këtyre tre personave dhe kanë ecur si paralel me automjet në drejtim të Pejës”.

Gruaja e tij ka dhënë deklaratë në polici se ajo e ka ditë se çka ka pas në shtëpi. Nuk e ka dit se kush është A.A por e ka përshkruar se çka ka pa në kamera, persona të gjatë, të ri, të lëvizshëm, por nuk ka mundur me identifikuar se kush kanë qenë për shkak të errësirës dhe largësisë, aty nuk kanë mundur me u vërejtur as tabelat, veç e di se ka qene kerr i bardh karavan. I njëjti po ashtu ka deklaruar se nuk shihet shtëpia e tij në ato kamera por shihet vetëm rruga, po ashtu as oborri nuk është pa në kamera, mirëpo është pa automjeti te hyrja e shtëpisë së tij dhe e ka pa kur ka dalë. I ka pa që kanë qenë tre persona tu ec, pastaj një person tjetër ka dal nga vetura dhe ju ka bashkangjitur tre personave tjerë, dhe shoferi me automjet ka shkuar.

Dëshmitari *Sh.B* në deklaratën e dhënë në rishqyrtim gjyqësor të dt. 06.01.2022 ka deklaruar se: - “në vitin 2014 ka punuar në hotel të kombinati në recepcion, se në atë kohë ka pasur telefon mobil i kujtohet se numri i telefonit ka qenë ky është numri qe ka poseduar në atë kohë dhe ky numër ka qenë në emër të vëllait të tij Sh. B. Këtë numër këtë kartel ja ka dhëne një djali me emrin A, i cili ka qenë një djalë nga Sh ka banuar aty në hotel, kogja një periudhë të gjatë ka banuar në hotel. A ja ka dhëne në shfrytëzim kartelën me numrin e cekur pasi që ai e kishte blerë një telefon nga A.A, dhe këtë ia ka thënë A. A ia ka kthyer menjëherë kartelën nuk e ka mbajtur as 2 - 3 sekonda dhe tha se nuk qenka telefoni i bllokuar dhe ma ktheje kartelën. Nuk e di saktë sa e ka mbajt kartelën time, por e di se veç sa e ka shti në aparat telefonike ka thënë se po punojka dhe me ka kthyer ai nuk e ka thirrë kërkon në telefon. Pastaj thotë se ka shkuar me kontrolluar dhomat për pastrim ai me ka kërkuar kartelën, pastaj kur jam kthyer në recepcion e kam parë qe e ka lenë në shank, nuk e di se çka ka bërë me të. I kujtohet se telefoni ka qene Iphone i vjetër, ndërkaq diçka tjetër nuk di. Nuk e kam pyetur, e di qe me ka thënë se veç e kam blerë, tani kur na ka dal neve probleme, pasi qe vëllain tim e kanë arrestuar policia, unë kam hyre në facebook i kam shkruar, dhe ai me tha se e ka blerë prej A.A dhe A punon si taksist. Dëshmitë janë se si e ka shkruar ai emrin dhe i kam prezantuar. Ai e ka pasur facebook me emrin A dhe aty shkuan edhe emri. Deklaron se të akuzuarin deri atë ditë që ka ndodhur rasti dhe kanë ardhur policia dhe e kanë arrestuar vëllain tem nuk e kam ditur se kush është, pasi qe jepem ato dëshmitë që me ka thënë A dhe me tha qe ai punon taksisë dhe unë e pash A ngase me emër nuk e kam njohur”

Më tutje i njëjti ka deklaruar se nuk mund të thotë kur i ka parë telefonin A , por ajo qe ka thënë në prokurori është me e sigurt, rasti ka qene me i freskët, nga se ka kaluar 8 vite. D T nuk e njeh. I ka dorëzuar mesazhet, por ato janë me emër A dhe B. B, ka shkruar prej kompjuterit dhe i ka printuar fjalët, biseda ka qenë në messenger. Pasi qe i ka shikuar mesazhet e nxjerra nga telefoni samsung, dëshmitari ka thënë se nuk mund ta di se a janë këto mesazhe pasi që nuk del emri i tij, i njëjti i ka thënë se telefonin e ka A por nuk i kujtohet qe i ka borxh, por e di që nuk i ka dal i mire telefoni dhe ja ka kthyer, shënimet nuk i ka ruajtur, por tri herë ka dhënë deklaratë në polici, në prokurori dhe një herë në Gjykatë. A nuk ia ka dit emrin por pasi u ballafaqua me deklaratën e dhënë në polici me dt. 29.10.2014, ku në faqen e parë ka theksuar se personin nga Sh që e kanë pasur në Hotel është quajtur K. I, i njëjti thekson se gjatë kohës sa ka punuar në Hotel “Sh “ia dinte emrin, por në hotel

ka qenë e regjistruar femra e tij. Pastaj i njëjti deklaron se A i ka thënë gjatë bisedës në facebook se telefonin e kishte blerë nga A. B.

Dëshmitari B.S në deklaratën e dhënë në rishqyrtim gjyqësor të dt. 06.01.2022 ka deklaruar se: te akuzuarin e ka njohur përmes pazarit meqë punon me tregti te kerreve, telefonin e ka blerë prej ti. “ Kur them e kam ble, sqaroi se kemi bërë një pazar me herët, dhe A me ka mbetur borxhe mua, dhe në emër të borxhit ma ka dhënë telefonin. E di qe një kerr me herët e kanë pas ndërrua dhe ky i ka mbetur borxhe. Koha nuk i kujtohet por ajo çka ka deklaruar me herët është e vërtete tash mundem me gabua”. Në polic çka ka deklaruar është e saktë dhe shuma sa i ka pasur borxhe A nuk i kujtohet mund të mos jete e saktë vlera prej 1.200 euro, telefonin e ka blere sa e ka pasur vlerën atë kohë, diku ka qenë 50 – 70 apo 80 euro, por shuma që e ka deklaruar ne polici qe e kam blerë telefonin është e saktë dhe atë telefon e ka dorëzuar në polici.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari A. A në mbrojtën e tij të dhënë në rishqyrtim gjyqësor të dt.04.04.2022 ka deklaruar: -“ se ka punuar taksi në vitin 2014 në firmën Në atë kohë nuk ka poseduar automjet personal. Telefonin i cili është temë shqyrtimi në këtë çështje penale, unë e kam blerë nga A, unë nuk ia kam dit emrin por e kam njohur si A. E kam pasur klientë, kur ka pasur nevojë për taksi i njëjti shpesh ka thirr në bazë dhe unë kam shkuar dhe e kam marr në hotel Sh. Telefonin unë e kam përdor rreth 1 muaj me numrin tim personal dhe e kam përdor kartelën time personale. Me vonë ia kam jep një shokut tim B. S i kam pas diçka borxhe, dhe mu ba marak në telefon tha rrëzohem ne borxh dhe ja dhashë. Për ato shkresa kam marrë vesh pasi që kam dal në gjykatë nuk e kam dit përpara, do me thënë në shqyrtimin e mëparshëm. Personin me emrin D. T nuk e njehë. Nuk ka poseduar automjete karavan, e as armë nuk di as të punoj me to. D. A e ka pa në gjykatë për herë të parë, se nuk ka pasur njohuri për vjedhjen e shtëpisë se tij. Shtëpia i është bastisur nga ana e policisë ky nuk ka qenë në shtëpi, në shtëpi ka qenë baba dhe nëna dhe ata i kanë treguar se nuk kanë gjetur asgjë të jashtë ligjshme. Nuk kanë konfiskuar asgjë. Personin A zakonisht e kam marrë te hotel Sh, dhe e kam que ku ka dashtë, dhe në lokalet e muzikës sepse ka punuar me disa femra. E kane dërguar edhe shoferët e tjerë te kompanisë. Sh. B atë e kam pa para hotelit në recepcion, se kur janë vonuar klientët ka dal dhe ka thënë prit pak, dhe emrin nuk ja kam ditur. Në atë kohë ka punuar vetëm në kompaninë taksi Në atë kohë kam punuar vetëm me taksi, gjersa më parë kam punuar me kerre, dhe prej vitit 2013 nuk kam punuar me kerre”.

Tutje deklaron se e ka pasur në posedim telefon IPHON-e me ngjyrë të bardhë dhe i njëjti telefon i është dhënë dëshmitarit B.S. Këtë telefon e kam marrë prej personit të quajtur A, A me ka thënë me vyen paret a don me ble telefonin, unë e kam marrë prej A dhe do para ja kam dhënë menjëherë, dhe tjerat i kam thënë ti jep ka pak, nuk më kujtohet saktësisht sa ja kam dhënë, kjo është e shkruar ne deklarate me parë. Numrin e telefonit të A nuk e kam dorëzuar sepse nuk kam mundur me gjet, se kam menduar qe është hala në hotel “Sh” tuj ndej, kam shkuar e kam lyp dhe nuk ka qenë. Mesazhet me D. T, i ka dorëzuar Sh. B, nga se në fillim është arrestuar vëllai i tij dhe këto i ka sjelle Sh. B, qe ka biseduar me atë person, por unë nuk e di a ka qenë A a po kush. Ne atë periudhë nuk i kujtohet se cilën sim-kartel e ka pas, por është e cekur në polici. Numri qe ka qenë i vendosur ne IPHONE qe është sekuestruar te B ka qenë numri im.

Sa i përket pyetjes se ditën kritike a ka qenë në V i njëjti ka deklaruar se : “ nuk me kujtohet saktë por ndodh qe kam qenë deri te kafi teria ne V, ato qe i kam thënë atëherë jam me te sigurta. Kafiteria, nuk i di Rajoni cili ka qenë. Nuk e di se A a ka punuar për

femra apo për sa femra ka punuar dhe se a ka qene bosi i tyre. Por, ne kemi shkuar dhe e kemi marrë në hotel. I kanë qu gjithkah në shumë pika, deklarata qe i kam dhënë përpara ju qëndron mbase.

I njëjti ka theksuar po ashtu se A nuk ia ka ditë emrin kurrë pasi qe ka ndodhur ky rast ka pyetur te hotel Sh dhe ata i kane thëne se e ka emrin K.I, por asnjëherë nuk i kanë siguruar të dhëna.

Fjala përfundimtare

Prokurorja Lumturije Vuçetaj në fjalën përfundimtare te dt. 05.04.2022 e ka paraqitur me shkrim ku ka theksuar: gjatë rigjykimit pas administrimit te provave personale dhe atyre materiale u provua se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprave penale për te cilat është akuzuar. Këtë e mbështesin në deklaratën e dëmtuarit D. A të dhënë në seancën e dt. 06.01.2022, nga e cila vërtetohet se në shtëpinë e tij me dt. 19.08.2014, janë marrë gjësendet e cekura në aktakuzë duke depërtuar me forcë, në mesin e gjësendeve te marra është edhe Iphone me ngjyre të bardhë e me numër te IMEIT, dhe i është kthyer në posedim nga policia pasi i është gjetur dhe sekuestruar dëshmitarit B.S.

Nga deklarata e dëshmitarit B.S e dhënë po të njëjtën seancë vërtetohet se i pandehuri A.A me dëshmitarin ka pasur bashkëpunim lidhur me disa shitblerje dhe telefoni ka qenë në posedim të këtij dëshmitari e të cilit nga ana e të pandehurit A i ishte dorëzuar, si rezultat i një pazari të mëhershëm. Nga deklarata e dëshmitarit Sh.B dhënë po të njëjtën seancë vërtetohet se sim-kartela ka qenë në përdorim nga ana e te njëjti po qe ishte evidentuar në emër të vëllait Sh.B. Kartela ka qenë e vendosur ne telefonin e cekur me lart nga ana e te ashtu quajhuri (A) kur ky i fundit kishte banuar ne Hotel Sh ne P, për derisa dëshmitari në fjalë ka punuar aty në recepcion dhe janë njohur në mes vete. Po ashtu u vërtetua edhe se në atë periudhë kohore e ka njohur edhe te pandehurin A i cili ka punuar si taksi dhe gjatë asaj kohe shërbimet e taksit A i ka kryer i pandehuri A.

Nga raporti ligjor i siguruar nga Ipko me numër 1006/2 e dt. 08.09.2014, i lëshuar sipas urdhërese se gjykatës Rez 2014/14, për periudhe kohore 05.07.2014, e gjerë me dt. 10.07.2014, dhe 20.08.2014, deri me 29.08.2014, ka rezultuar se ne telefonin Iphone të cekur si me lart ka qene e kyçur sim kartela me numër, dhe sim kartela ne posedim te Sh.B, dhe sim-kartela në posedim të A.A. Nga vërtetimi mbi konfiskimin e pronës vërtetohet se dëshmitarit B.B i ishe konfiskuar një telefon Iphon me numër të cekur si me lart. Po ashtu nga foto të deponuara nga dëshmitarit Sh. B vërtetohet se komunikimi qe është bërë në mes të personit të evidentuar D. T ku i fundit ka shkruar se telefoni Iphone ka qenë në posedim të personit (A.B) e cila bisede është zhvilluar pas rastit të parashtruar në polici dhe është bere nga dëshmitari për të vërtetuar se telefoni ka qenë në posedim të lartcekurit.

Nga mbrojtja e të akuzuarit A.A e dhënë në seancën e dt. 04.04.2022 vërtetohet se i njëjti në periudhën kohore kur është kryer vepra penale ka punuar si taksi e qe ka kryer shërbimet e kërkuara nga ana e personit te quajtur A i cili ka banuar ne Hotel Sh, dhe se në atë kohë e ka njohur edhe dëshmitarin Sh.B ku kishte punua në këtë hotel. Njëkohësisht telefoni Iphone ju është dhënë ne kompozim për një borxh paraprak për tregti të veturave. Andaj konform të lartcekurave konsideron se u vërtetua ne tërësi se i akuzuari A.A është penalisht përgjegjës për vepra penale për të cilat është akuzuar, andaj kërkojmë nga ana e gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale si dhe dëmit të shkaktuar.

I dëmtuari *D.A në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar se ka kërkesë për dëmshpërblim dhe se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurores.

Mbrojtësi i te akuzuarit *A.A av. Shaban Shala*, fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim dhe të njëjtën e ka lexuar para gjykatës. I njëjti ka theksuar se gjatë seancave të mbajtura në çështjen penale të *A.A* për vepra penale të cekura si në aktakuzë, me pa dyshim është vërtetuar se i mbrojturi i tij *A. A* nuk i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar sipas aktakuzës PP.nr. 388/14, te dt. 11.10.2015. Nuk është vërtetuar se i njëjti është fajtorë nga asnjë provë materiale dhe as procedurale. Sa i përket veprës penale të vjedhjes së rëndë me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer. Nuk ka shenja nga krim teknika të marra në vendin e ngjarjes e të cilat do të vërtetonin prezencën e tij në kryerjen e veprës penale, po ashtu as nga incizimet nga kamerat e fjinjës së palës së dëmtuar nuk është vërtetuar se i njëjti ka qenë aty. I dëmtuari *D.A* në prokurori ka deklaruar se këto incizime të kamerës nuk e ka vërejtur figurën e të mbrojturit të tij dhe ndërkaq në shqyrtim gjyqësor tenton ta përshtat lartësinë e shtatit të tij pasi që e ka pa të njëjtin, ka qenë terr dhe nuk ka mundur ti identifikoi. Ndërkaq në shqyrtim gjyqësor deklaroi se shtëpia e tij nuk shihet nga shtëpia e fjinjës, por përshkruan se si janë vërejtur hajnat duke hyrë me automjet në oborrin e shtëpisë së tij. I dëmtuari cek se i ka pa tre personat të cilët i është bashkangjitur edhe personi i katër ku del nga automjeti i bardh nga oborri i shtëpisë së tij dhe të njëjti shkojnë në këmbë pas dhe anash atij automjeti në drejtim të P.

Mbrojtësi thekson se me dt. 19.08.2014, rreth orës 20:00/h, ku pretendohet se është kryer vepra penale është e ndriçuar pamja për shkak se është vere dhe koha fillon të errësohet pas orës 21:00/h, dhe është absurde të mendohet se hajnat pas kryerjes së veprës penale të ecin në këmbë jo të futen në automjet e të largohen sepse nuk kanë mundur të ikin si me qenë duke shkuar në dasmë e të lëvizin ngadalë pas automjetit siç ka deklaruar i dëmtuari. E gjithë deklarata e të dëmtuarit është e pa bazuar përveç gjerave të vjedhura edhe pse nuk janë verifikuar se janë vjedhur të gjitha ato apo jo.

Dëshmitari *Sh.B* sipas mbrojtjes sjellë edhe më shumë paqartësi ku nuk e tregon emrin e vërtetë të personit të quajtur "A" i cili shumë kohë ka qëndruar në hotelin *Sh*, ku dëshmitari ka punuar në recepcion, dhe sipas deklaratës së tij kuptohet se ka pasur edhe raporte të mira me të. I njëjti ka deklaruar se personi nga *Sh* me emrin *A* i cili ka qëndruar me ditë në hotel *Sh* ku ky kishte punuar në recepcion, një ditë ia kishte kërkuar kartelën e telefonit të tij për ta provuar telefoni *Iphone 4*, se a është në rregull dhe pas disa sekondave ia ka kthyer, e që bije në kundërshtim me deklaratën e tij pasi që më pas deklaroi se nuk ka mundur për një ose dy sekonda me ja kthyer pasi që ai e ka marrë kartelën e telefonit pastaj ka shkuar në dhomën e tij e pastaj ja ka kthyer kartelën. *A* i i ka thënë se këtë telefon e ka blerë nga *A.B* gjë që nuk qëndron sepse sipas nxjerrjes së bisedave telefonike që gjenden në shkresat e lëndës të prezantuar në policia nga vete ky dëshmitar vërtetohet e kundërta e deklaratës së tij. Në këto biseda shkruan se i është kërkuar këtij dëshmitari të i merr 75 euro të cilat nuk ja ka paguar *A* për telefon, e të cilin e ka blerë *A* nga ai. Shtrohet pyetja a ja ka shitur *A* telefonin *A* apo *A* ja ka shitur *A*? Sipas kësaj prove del se *A* ja ka shitur telefonin *A*.

Dëshmitari nuk e tregon emrin e vërtetë të personit *A*, duke dhënë një emër tjetër në polici, sepse nga biseda në telefonin *samsung* shife emri *D.T*. Këtu ekziston dyshimi se ky dëshmitar e inskenon shkrimin telefonik me të ashtuquajtur *D.T*, sepse pasi që i dërgon këto mesazhe në polici vëllai i tij *Sh.B* lirohet nga paraburgimit, dhe pas një kohe arrestohet i mbrojturi i tij. Deklaratës së dëshmitarit *Sh.B* nuk duhet fal besimin por me plotë të drejtë ishte dashur të ngritët procedura për dëshmi të rrejshme.

Nga dëshmitari B.S rrjedhë se i mbrojturi i tij ka shitur një telefon “Iphone 4” të cilit ia ka shitur për borxhe. Te cilin telefon e kishte bartur edhe vete i akuzuari. I akuzuari nuk e ka kryer veprat penale andaj edhe nuk e ka pranuar fajësinë edhe pse personin me emrin A e kishte njohur si person te cilin e kishte marrë me automjetin taksi nga hoteli Sh dhe këtë shërbim ai e ka bërë sipas urdhrin nga firma Taksi V. I akuzuari e ka pranuar se nga A e kishte blere telefoni Iphone 4 e kishte përdorur për afërisht 1 muaj ku dhe ja kishte dhënë personit B.S, për një borxhe qe ia kishte pasur. Sikur të kishte dit që telefoni ishte i vjedhur nuk do të kishte blerë dhe as nuk do ta kishte përdor me kartelën e tij. Me tutje thekson se asnjë nga gjerat e cekura në aktakuzë nuk janë gjetur tek i akuzuari dhe kjo gjë vërtetohet me rastin e bastise se shtëpisë se të mbrojturit të tij ku policia nuk ka gjetur asgjë. Ne shtëpinë e tij nuk është gjetur as pushka e gjuetisë e si mund të akuzohet një person për një veprë penale qe objekti i veprës penale nuk është gjetur te ai. Prokuroria me rastin e ngritjes se aktakuzës si në piken dy, ndaj të mbrojturit të tij nuk ka pasur asnjë provë se i njëjti ka poseduar, përdorur apo keqpërdorur ndonjë armë të cilën kurrë nuk e kanë gjetur. Në fund i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit të gjitha provave të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësorë të akuzuarin A.A ta liroi nga aktakuza në mungesë të provave dhe të njëjtin ta shpallë të pafajshëm.

I akuzuari ne fjalën e tij përfundimtar ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare te mbrojtësit te tij, nuk ka diçka për të shtuar.

* * *

Gjykata pas përfundimit te shqyrtimit gjyqësor i ka vlerësuar te gjitha provat e administruar një nga një dhe ne lidhmëni reciproke me njëra tjetrën dhe ka gjetur se i akuzuar A A nuk është fajtor për veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 327 prg 2 pika 2.1 dhe 2.5 të KPRK-së, dhe veprë penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 të KPRK-së. Vepra këto te kryera në dem të dëmtuarit D. A, pasi që nuk u provua se i njëjti kishte kryer këto vepra penale.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të fakteve:

-nuk u kontestuan faktet që kanë të bëjnë lidhur me veprat penale, si dhe fakti se në shtëpinë e të dëmtuarit ishte vjedhur edhe telefoni “Iphone 4” me numër IMEI IMEIT –në të cilin kishte qenë kartelet me numër, si dhe gjësendet e tjera të vjedhura të cekura si në dispozitiv të aktakuzës.

-Nuk ishte kontestuese se telefoni “Iphone 4” me numër IMEI dy ditë pas kryerjes së veprës penale do të thotë me dt.21.08.2014 ishte përdorur nga numri i telefonit, numër ky që e shfrytëzonte dëshmitari Sh.B, por që ishte në emër të vëllai te tij Sh.B.

-Nuk u kontestua se telefoni në fjalë ishte përdorur nga këtu i akuzuari A.A me numër telefonit, dhe qe pastaj të njëjtin ia kishte shitur përkatësisht ia kishte kompensuar për një pjesë të borxhit dëshmitarit B.S.

-Nuk u kontestua se telefoni ishte gjetur te dëshmitari B.S pas lëshimit te masave te fshehta ku dhe i njëjti i ishte konfiskuar dhe ishte kthyer te dëmtuarit D.A.

Kontestuese ishin faktet qe kane te beje me kryesin e veprave penale dhe lidhmerin e të akuzuarit A.A me veprat penale?

Pikërisht faktet kontestuese e kanë bërë aktakuzën e prokurorisë se te pa bazuar.

Vlerësimi i provave

Asnjë nga provat të administruara në shqyrtim gjyqësorë nuk vërtetohet se i akuzuari A.A të këtë qenë personi i cili natën kritike të këtë hyrë me forcë në shtëpinë të dëmtuarit dhe të këtë marrë gjësendet e cekura në aktakuzë.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e të dëmtuarit – dëshmitar të dhënë para gjykata në rishqyrtim gjyqësor po ashtu edhe në shqyrtimin e mëparshëm si dhe në deklaratat e dhëna në prokurori dhe në polici pranë të cilave mbeti edhe në shqyrtim gjyqësor. Nga dëshmia e të dëmtuarit D.A përveç që vërtetohet se kur ishte kthyer në shtëpi natë kritike gjithçka kishte qenë rrëmujë dhe sendet që i janë vjedhur që janë cekur në aktakuzë, nuk vërtetohet se i akuzuari anë ndonjë rrethanë të jetë parë apo identifikuar nga ai.

I dëmtuari ka deklaruar se *“pas dy – tri dite kishte shkuar të fciu i tij dhe i kishte shikuar kamerat aty i kishte parë një automjet që kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së tij kishte parë tre persona pastaj ju kishte bashkangjitur një person i katër dhe të njëjti kishin ecur paralel me automjet në drejtim të P, automjeti kishte qenë i bardhë karavan dhe personat kanë qenë të gjatë të rinjë dhe të lëvizshëm por nuk kanë mundur me identifikuar se kush ka qenë për shkak të errësirës e po ashtu nuk ka mundur me pa as tabelat e automjetit. Ky e kishte parë automjetin të hyrja e shtëpisë së tij, sepse oborri nuk shihet në kamera”*. Pra nga kjo dëshmi e dëmtuarit nuk mund të vërtetohet që i njëjti të këtë parë të akuzuarin A që ka hyrë në shtëpinë e tij, përkundrazi nga kjo vërtetohet se ka qenë më shumë se një person me rastin e kryerës së veprës penale të vjedhjes së rëndë.

Gjykata e vlerësoj edhe dëshminë e dëshmitarit Sh.B dhe nga kjo dëshmi gjykata përveç se vërtetoj faktin se e kishte pasur në posedim numrin e telefonit dhe ky telefon ishte i regjistruar në emër të vëllai të tij Sh.B, dhe këtë numër e telefonit përkatësisht kartele ia kishte dhënë personit të quajtur “A” për ta verifikuar telefonin se a është në rregull, pjesa tjetër e deklaratës së tij ishte kundërtënëse me vetveten dhe në kundërshtim me deklaratat e tij të mëparshme dhe provat e tjera materiale.

Ky dëshmitar bie në kundërshtim gjatë dhënies së deklaratës së tij, me deklaratën e dhënë në polici dhe prokurori sa i përket fakteve: sa e kishte mbajtur A sim-kartën kur sipas tij ia kishte dhënë për ta provuar telefonin, sa i përket se kur A i kishte thënë se telefonin në fjalë e kishte blerë nga taksisti A, si dhe faktit se ku dhe më kënd kishte shkruar në messenger të FCB.

Lidhur me faktin se sa e kishte mbajtur telefonin personi i quajtur “A” kur ky ia kishte dhënë për ta provuar në rishqyrtim i njëjti ka deklaruar se *“A ja ka dhënë në shfrytëzim kartelën me numrin e cekur pasi që ai e kishte blerë një telefon nga A. A, dhe këtë ma ka thënë A. A me ka kthyer menjëherë kartelën nuk e ka mbajtur as 2 - 3 sekonda dhe tha se nuk qenka telefoni i bllokuar dhe me ktheje kartelën. Do me thënë nuk e di saktë sa e ka mbajtur kartelën time, por e di se veç sa e ka shti në aparat telefonike ka thënë se po punojka dhe me ka kthyer ai nuk e ka thirre kërkon në telefon”*.

Në prokurori cek se : *“personi i quajtur “A” e ka pas në posedim gjatë kohës kur rrinte natën në Hotel atë ia kam vërejtur në dorë gjersa një ditë sapo unë shkova në punë ka qenë mbrëmje diju rrethe 18:-40 min ka ardhur A dhe e ka pyetur a ke numër të telefonit kartel që ta provoj këtë telefon që e kam blerë prej A në vlerë prej 70 euro , pra më ka thënë se e ka blerë prej A A dhe se e përsëris se dy tri dit më herët ia kamë vërejtur disa herë telefonin në dorë duke e mbajtur, ashtu që ia ka dhënë kartelën ai e mori dhe shkoj në dhomë e ka provuar në dhomë të*

hotelit dhe pas 5 miturave ma ka kthyer përsëri dhe më ka thënë se telefoni është në rregull.... telefonin edhe dy tri dit më pas e ka mbajtur A”.

Sa i përket komunikimit me mesazhe në mesengjer-FCB i njëjti para gjykatës tha: *“pasi që vëllain tim e kanë arrestuar policia unë kam hyrë në facebook i kam shkruar ai më tha se e ka blerë prej A, ai e ka pas në facebook emrin A dhe aty shkruan emri A.A dhe A punon si taksist, dëshmitë janë se si e ka shkruar emrin dhe e kam prezantuar , pastaj: “se komunikimi ka qenë me emrin A dhe B.B dhe se ka biseduar nëpërmes të kompjuterit në të, nuk i kujtohet se i ka thënë që i ka borxh, por di që nuk i ka dal mirë telefoni dhe ai ia ka kthyer”.* Përderisa në deklaratën e dhënë në polici i njëjti thekson se A i ka thënë se telefonin e ka blerë prej A.B, ndërkaq nuk e përmend se a me çfarë mjeti komunikimi por thekson se ka por vetëm thekson se mesazhet i ka dërguar në polici. Mirëpo emri A. B rrjedh edhe nga mesazhet e fotografuara në shkresa të lëndës që janë bërë në telefonin samsung.

Në prokurori i njëjti për personin e quajtur A.B thekson se nuk e njehë dhe sa e manë mend këtë pëson e ka përmend i pandehuri A.A por nuk di ma shumë për të.

I njëjti bie në kundërshtim me vet vetën kur i njëjti deklaron se A e ka provuar telefonin dhe i ka dhënë në rregull është e më pas deklaron se telefoni nuk i kishte dal i mirë dhe ia kishte kthyer, përderisa këtë nuk e cek me rastin e dhënies së deklaratës në polici.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha kundërthëniet e cekura si më lartë, erdhi në përfundim se deklarata e dëshmitarit Sh.B është në kundërshtim me vet vetën edhe me provat materiale, veçanërisht me mesazhet në messsenget te FCB, andaj edhe nuk i fali besimin.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit B.S nga e cila vërtetohet se telefoni e kishte blerë nga këtu i akuzuari A.A, gjë që nuk u kontestua nga vetë i akuzuari por as në këtë deklaratë nuk u vërtetua se i akuzuari A. A ta kishte blerë telefonin nga personi i quajtur A apo ta ketë vjedhur telefonin në fjalë.

Nga raporti i Ipkos i dt. 09.08.2014, rrjedhë se numri i telefonit është në emër të Sh.B, dhe është regjistruar me dt. 14.08.2014, ne ora 17:53:05 minuta, ka filluar përdorimin me dt. 21.08.2014, ne ora 18:26:48 sekonda është përdorur deri ne ora 18:26:51 sekonda ka përfunduar dhe ky përdorim është bere vetëm dy ditë pas veprës penale.

Gjykata i vlerësoj mesazhet telefonike te cilat ishin dorëzuar ne polici nga ana e dëshmitarit Sh.B e qe sipas prokurorisë vërtetohet e A.A ja kishte shitur telefonin A. Nga këto mesazhe rrjedhë komunikimi i dy personave ku dëshmitari pretendon se ka a komunikuar me personin e quajtur A. Mesazhet kur fillon biseda për telefonin janë si në vijim:

Personi NN (nuk shënon emri): *“ vëlla çka pate bo me Iphone e bardhe a e ki hala”* D T: *“ jo e ka taksist a e ke takuar “.* Personi NN: *“ qysh e ka pasur emrin ai taksisti “,* D T: *“ me tha do te vije te takoi por nuk erdhi, A.B “.* Personi NN: *“ i kahit u kanë, a është hala tu punu taxi ”,* D. T: *“ si di pa na nr. ”.* Personi NN: *“ a është hala tu punu taksi ”* D. T: *“ nuk e di po thire në tel ”.* Personi NN: *“Sa ta pat shit telin ty aiii”,* D. T: *“ 75 euro i ka përtdhon mu po e ka telefonin merrja ti”.* Personi NN: *“stika kthyer paret a”,* D. T. *“ jo hala nuk mi ka kthyer paret”.* Personi NN: *“ aha do me thëne A e ka telin hala sas”,* D T: *“e vëlla flasim për 25 minuta”,* Personi NN: *“ ok vëlla “,* D. T: *“po hala e ka ai”.* Personi NN *“ok flm shumë”.*

Nga këto fotografi rrjedhë komunikim ne messenger-fcb në mes të dy personave dhe atë D.T dhe personit tjetër që nuk mund të konstatohet emri. Lind pyetja se nëse pësoni tjetër është këtu dëshmitarit Sh.B i cili i ka dorëzuar këto mesazhe kush është tani personi “D. T” apo a u vërtetua se ky person ishte i ashtuquajtur “A”? Ne anën tjetër nga këto mesazhe a vërtetohet pretendimi i prokurorisë se aty është shënuar se telefonin A e kishte blerë nga i akuzuari A.A”.

Nga këto mesazhe telefonike nuk vërtetohet se person D.D është personi i quajtur A e as fakti se i akuzuari A.A te këtë shitur telefoni personit te quajtur A, sepse nga kjo bisedë kuptohet se personi për te cilin dëshmitarit Sh.B ka pretenduar se është A dhe qe ka bërë shkëmbim të mesazheve në Messenger të FCB të cekura si më lartë, në asnjë moment nuk cekë se telefonin e kishte blere nga këtu i akuzuari madje ai thotë se “ ka për të mi dhënë edhe 75 euro” madje i thotë merrja ti telefonin. Andaj me këtë vërtetohet se këtu i akuzuari nuk i kishte shit telefonin A. Pastaj personi NN e nxit bisedën “sa ta pat shit telefonin” edhe pse ai nuk thotë se ka blerë telefon nga ai, pastaj duke i thënë” se hala nuk ti ka kthyer paret”.

Nga te gjitha këto rrjedhe se nuk ka prova qe vërtetojnë se këtu i akuzuari A.A të këtë kryer vjedhjen e rëndë natën kritike dhe më pas të ia këtë shitur telefonit personit e quajtur A. Nga provat e administruara rrjedhe se personi i parë qe e ka pasur telefonin në shfrytëzim dy ditë pas kryerjes së veprës penale ka qenë numri e që ishte ne posedim të Sh.B, por i regjistruar në emër të Sh.B.

Në vendin e ngjarjes ishin marrë gjurmët gjë që vërtetohet rezultati i ekzaminimit nga Njësia e Forenzikës Sektori i Afisit i dt. 24.09.2014, por që nuk kanë rezultuar me ndonjë identitet të ndonjë personi.

Gjykata nuk kishte në dispozicion procesverbalin e bastisjes edhe pse janë lëshuar urdhëresa për bastisje, dhe këtë procesverbal e ka kërkuar mbrojtësi gjatë shqyrtimit të mëparshëm dhe tani në rishqyrtim gjyqësor nga se në deklaratën gjatë marrjes në pyetje të dëmtuarit D. A në prokurori me dt.19.11.2014, në faqen 3 në pasusin e fundit ku ceket se “i dëmtuari u njoftua me shkresat e lëndës e sidomos me bastisjen që është bërë në shtëpinë e të pandehurit A. A”. Mirëpo edhe përkundër që gjykata nuk e kishte në dispozicion një procesverbal të tillë, nga raportet policore dhe nga shkresat e lëndës nuk rrjedhë se në shtëpinë e të akuzuarit të jetë gjetur ndonjë nga gjësendet apo arma të vjedhura në shtëpinë e të dëmtuarit.

I akuzuari e pranon se një kohë e kishte pas në posedim telefonin “IPHON 4” dhe të njëjtin e kishte blerë nga A, dhe pas një kohe ia kishte shitë dëshmitarit B. S. Mirëpo nuk ka prova që vërtetojnë që i akuzuari ta këtë kryer vjedhjen e rëndë natën kritike dhe ta këtë pas në pronësi apo përdorim armën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk mund ta shpall fajtor të akuzuarin vetëm mbi bazën e asaj se i akuzuari e ka pas në shfrytëzim telefonin në fjalë e që ia kishte shit dëshmitarit B. S, gjithnjë duke pas parasysh se telefoni dy ditë pas kryerjes së veprës penale për herë të parë ishte shfrytëzuar nga numri e që ishte në posedim të Sh.B e që ky nuk kishte ndonjë kontakt me të akuzuarit në lidhje me telefonin.

Marr parasysh të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit për asnjërën nga veprat e cekura si në aktakuzë, andaj gjykata është dashur që të gjitha dyshimet ti interpretoj në favor të akuzuarit dhe mbrojtjen e tij ta merr për bazë.

Pretendimi i prokurorisë se i akuzuari në atë kohë ka qenë i njohur si kryes i veprave penale nuk mund të merret si provë për ta shpallur fajtor të akuzuarin, por do të vinte në shprehje vetëm te matja e dënimit në rast se i akuzuari do të shpallej fajtorë.

Gjykata bazuar në dispozitën e neni 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së e liroj nga aktakuza të akuzuarin pasi që nuk u provua se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Konform nenit 454 të KPRK-së gjykata vendosi lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

I dëmtuari në shqyrtim gjyqësor tha se ka kërkesë për dëmshpërblim, për çka gjykata konform nenit 463 par. 3 e udhëzon në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
2018:033010, 10.05.2022**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.